

Për:	Operatorë Ekonomik: “ALBI COMPANY” SHPK me adresë në Rahovec Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	10.04.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim**, të datës: **07.04.2023**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: “ALBI COMPANY” SHPK, me adresë në **Rahovec**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RENOVIMI I OBJEKTIT TË VJETËR TË QKMF – së NË RAHOVEC - FAZA E DYTË**, me Numër të prokurimit: **623-23-2312-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-029-5-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **APROVOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: “ALBI COMPANY” SHPK, me adresë në **Rahovec**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RENOVIMI I OBJEKTIT TË VJETËR TË QKMF – së NË RAHOVEC - FAZA E DYTË**, me Numër të prokurimit: **623-23-2312-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-029-5-2-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **22.03.2023**, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave, pika **II. Kurdo qe miratimi i kërkesës ndërlidhet me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, Autoriteti Kontraktues do të beje publikimin e Njoftimit për korrigjim te gabimeve, duke përdorur formularin B54**
- III. **Vërejtje:** Komuna do të bëjë korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara sipas Ligjit të Prokurimit Publik **për Pretendimet ankimore qe janë pjesërisht të bazuar.**
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: “ALBI COMPANY” SHPK, me adresë në **Rahovec**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RENOVIMI I OBJEKTIT TË VJETËR TË QKMF – së NË RAHOVEC - FAZA E DYTË**, me Numër të prokurimit: **623-23-2312-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-029-5-2-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **22.03.2023**, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **07.04.2023**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE TË KËRKESËS

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

Nuk ka ofruar sqarime rreth projektit -detajeve per punet e parashikuar ne paramase,

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar, pasi që tek Dosja e Tenderit, përkatësisht te ANEks 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME, janë dhënë Detalet sipas pozicioneve të parashikuara në paramase, siq janë DETALI A, DETALI B dhe DETALI C, shih faqen Nr. 17 të Dosjes së Tenderit.

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:

Kriteri i kerkuar nr 2.7 te kerkesa 2 per se paku 2 Salldues te certifikuar sipas EN ISO 9606-1 me certifikate valite eshte e pa nevojshme pasiqe ne paramase dhe paralogari nuk jane parashikuar pune salltues qe nenkupton nuk jane relevant me natyren e puneve.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:

Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (EDT):

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale (9.1 & 9.2):

Në Vend të:

2.7. Dy salldues të certifikuar sipas ISO EN ISO 9606-1 me qertifikata valide.

Ne bazë të Konsultimeve me Ligjin e Prokurimit Publik dhe Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, kërkesa juaj Aprovohet e bazuar dhe kriteri.

Me formular B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara.

Korrigjohet në:

2.7. Dy salldues të certifikuar sipas ISO EN ISO 9606-1 me qertifikata valide.

Për këtë aktivitet të prokurimit nuk do të zbatohet (do të tërhiqet) Kërkesa e më sipërme e Dosjes së Tenderit - (Dy salldues të certifikuar sipas ISO EN ISO 9606-1 me qertifikata valide).

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës se Prokurimit
Komuna e Rahovecit